



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3186/6 prot

Datë 11.01.2024

V E N D I M

Nr. 42/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.01.2024 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Sead-SGS” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-89259-11-30-2023, me objekt: “*Blerje artikuj të ndryshem ushqimor (shkolla Speciale 3 Dhjetori dhe Konvikti i shkolles Artistike)*”, me fond limit 2,436,275 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 11.12.2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër, me adresë: Rruga “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër.

Ankimues: Operatori ekonomik “El-Gjo 2006” SHPK, me NIPT (J66902033R), me adresë: Lagjja “Tre Heronjtë”, Rruga “Pal Engjëlli”, Zona kadastrale 8593, Nr.pasurie 10/630, 4001, Shkodër.

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Sead-SGS” SHPK, me NIPT (L61725018G), me adresë: Lagjja “Kashar 2”, Rruga “Mullishtër”, godinë 1-katëshe, nr.pasurie 4, Zona Kadastrale 2105, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 05.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 01.12.2023 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshuar”, me Nr. REF-89259-11-30-2023, me objekt:

“Blerje artikuj të ndryshem ushqimor (shkolla Speciale 3 Dhjetori dhe Konvikti i shkolles Artistike)”, me fond limit 2,436,275 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 11.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 14.12.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|-------------------------|-----------------------------|
| 1. “Sead - SGS” SHPK | 1,681,580 lekë, kualifikuar |
| 2. “El – Gjo 2006” SHPK | 1,912,380 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 19.12.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak në SPE.

II.4. Në datën 22.12.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 3186 prot., datë 22.12.2023, e operatorit ekonomik “El-Gjo 2006” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Sead-SGS” SHPK.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 3186/2 date 26.12.2023, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “El-Gjo 2006” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Sead-SGS” SHPK.

II.6. Në datën 03.01.2024, në adresën e emailit Kpp_info@kpp.gov.al të Komisionit e Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka paraqitur shkresën nr. 20085/1 prot. datë 29.12.2023, me objekt: “Kthim - përgjigje”, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar atë.

II.7. Me shkresën nr. 82 prot, datë 04.01.2024, me objekt: “Informacion” protokolluar me tonën me nr. 3186/3, datë 08.01.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor mbi procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi si akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “El-Gjo 2006” SHPK, si dhe argumentimi ekonomik i ofertës dhe analizës së çmimeve të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “Sead -SGS” SHPK, së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime

nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “El – Gjo 2006” SPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Sead – SGS” SHPK me arsyetimin se *“Duke u bazuar në këtë pikë ne e quajmë të kualifikuar jo korrektësisht si fitues operatorin ekonomik SEAD*SGS dhe kërkojmë rikontrollim të dokumentacionit vërtetues për ofertën anomalisht të ulët me qëllim verifikimi, ku nëse ka mangësi, të refuzohet ky operator dhe të vazhdojë procedura me operatorin tjetër ekonomik në radhë.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën nr. 82 prot, datë 04.01.2024 me objekt: *“Informacion”*, protokolluar me tonën me nr. 3186/3 datë 08.01.2024, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët, ka konstatuar, se oferta e shoqërisë “Sead - SGS” SHPK është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte KVO në datë 11.12.2023, nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik, i është drejtuar operatorit ekonomik “Sead - SGS” SHPK, me kërkesë për sqarim/ argumentim oferte anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së.

III.1.2.2. Në përgjigje të kërkesës së KVO, më datë 14.12.2023, operatori ekonomik “Sead - SGS” SHPK me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, dokumentacionin si më poshtë:

- Shkresë datë 14.12.2023, me objekt: *“Argumentimi ekonomik i ofertës dhe analizë cmimesh”*, ku ndër të tjera, thuhet se: *“[...] Bazuar ne kerkesen tuaj te mberitur prane nesh nepermjet faqes se app me date 11.12.2023, po ju paraqesim argumentimin ekonomik te ofertes tone si dhe analizat e cmimeve per te gjithë elementet perberes te preventivit, ne lidhje me proceduren e prokurimit te zhvilluar me date 11.12.2023 nga Bashkia Shkoder me objekt “BLERJE ARTIKUJ TE NDRYSHEM USHQIMORE (SHKOLLA SPECIALE 3 DHJETORI DHE KONVIKTI I SHKOLLES ARTISTIKE” me fond limit 2 436 275 leke pa TVSh. Ne lidhje me oferten e paraqitur nga shoqeria jone sqarojme se ofrojme nje zgjidhje teknike te ofertes, bazuar ne disa faktor si vijon:
Se pari, kemi burimet e mjaftueshme financiare per te realizuar objektin e tenderuar.
Se dyti, subjekti ka eksperience shume te gjere ne fushen e punimeve te se njejtes natyre me objektit e prokuruar nga ana juaj , me aktivitet qe nga viti 2016.*

Se treti, ne kemi ne stafin tone drejtues teknik te profesioneve te ndryshem si Kimist, Teknolog, Veteriner, Shofer, Shpempdares ushqimi dhe fumitor qe perbejne nje garanci te mjaftueshme per realizimin e objektit te prokurimit. Po ashtu do te angazhohen edhe specialiste te tjere nese eshte e nevojshme.

Se katerti, ne kemi mareveshje bashkepunimi me furnitor te ndryshem qe ne teresi prodhojne dhe tregtojne te gjithe artikujt e tenderit. Para dhenies se ofertes kemi marre oferta per te gjithe artikujt perberes te preventivit. Konkretisht nga subjekti “A-D-E-G” sh.p.k. me nipt K 86604010 G, subjekti “Ersen Muja” P.F. me nipt L96602005 L, subjekti “Andi Cocja” P.F. me nipt K 66702005 H. Po ashtu kemi edhe mallra gjendje ne magazine sipas fatures respektive te blerjes.

Nese do jemi fitues te kesaj procedure prokurimi do zbatohen me perpikmeri te gjitha rregullat e sigurimit teknik te percaktuara ne Kodin e Punes, do te zbatohen edhe te gjitha detyrimet per kategorite e punetoreve.

Do bashkerendojme fuqine punetore te kualifikuar me realizimin ne cilesi shume te mire te shperndarjes se ushqimit ne vendet dhe oraret e percaktuara nga AK. Origjinaliteti i puneve tona vertetohet me ane te CV-se se shoqerise tone ne te cilen pasqyrohen objekte te realizuar sipas kerkesave te investitoreve pothuaise ne te glitha vendet e Shqiperise fshkoder, Tirane, Kukes, Rreshen, Lezhe, etf).

Gjithashtu kemi automjete ne cilesi shume te mire, qe sherbejne per shperndarjen e artikujve dhe ruajtjen e tyre ne cilesi shume te mire.

Per pjesen me te madhe te artikujve perberes te preventivit kemi kontrata furnizimi me prodhuesit te cilat jane ngarkuar ne SPE.

Referuar statusit te subjektit dhe experiences se tij disa vjecare kemi akses te plote per te marre ndihme shteterore duke qene se jemi treguar shume korrekt me te gjitha institucionet e administrates shteterore. Po ashtu kemi edhe mundesi financimi nga bankat e niveleve te dyta.

Persa i perket anes ekonomike bazuar sa me siper, ne momentin e pergatitjes se ofertes eshte menduar qe fitimi eventual nga ana jone te jete fare minimal dhe objekti te realizohet ne kohen dhe cilesine e duhur.

Bashkangjitur ofertat paraprake dhe faturat e blerjes.”

- Ofertë për subjektin “Sead – SGS” SHPK me NIPT: L61725018G, nga subjekti “A-D-E-G” me Nipt: K86604010G, datë 07.12.2023, për listën e artikujve si më poshtë: *sheqer; miell; fasule; makarona; oriz; vaj gatimi; niseshte; erëza; kripë; sup pule; salcë; maja birre; caj; qese plastike; biskota.*, ku listohet artikulli, sasia, njësia, dhe cmimi me TVSh.
- Ofertë për subjektin “Sead – SGS” SHPK me NIPT: L61725018G, nga subjekti “Ersen Nurja” me Nipt: L96602005I, datë 07.12.2023, për listën e artikujve si më poshtë: *Mollë; banane; fruta; qepë*, ku listohet artikulli, sasia, njësia, dhe cmimi pa TVSh.
- Ofertë për subjektin “Sead – SGS” SHPK me NIPT: L61725018G, nga subjekti “Andi Çoçja” me Nipt: K66702005H, datë 07.12.2023, për listën e artikujve si më poshtë: *djathë kaçkavall, djathe i bardhë, kos, vezë, mish i grirë, mish pulë, qebap, sallam (popullor), kofshë pule, parizier viçi, gjalp*, ku listohet artikulli, sasia, njësia, dhe cmimi me TVSh.

- Faturë nr. 55 datë 15.02.2023, me shitës DIS dhe blerës “Sead SGS” SHPK për artikujt “Mollë, dardhë, portokalle, klementinë, rrush, kumbull”, ku listohen “Njësia, sasia, çmimi për njësi pa TVSh., Morma TVSh, vlera pa TVSh, TVSh, vlera totale”.

III.1.3. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]”

III.1.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.1.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Sead - SGS” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, konstatohet, se oferta ekonomike në vlerën prej 1,681,580 lekë pa TVSh , në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Theksojmë faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”,

nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu, është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë *mundësinë* e tyre për të përfutur ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. **Gjykojmë, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, theksoj, se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “*Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si**

anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gëjkon vetëm mbi dokumentet e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe *mundësinë* për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Sead-SGS” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, vlerësojmë, se operatori ekonomik “Sead-SGS” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative datë 14.12.2023, me objekt: “*Argumentimi ekonomik i ofertës dhe analizë cmimesh*”, ku ka shpjeguar të gjitha elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë. Konkretisht ankimesi ka deklaruar se: “*...Se pari, kemi burimet e mjaftueshme financiare per te realizuar objektin e tenderuar.*

Se dyti, subjekti ka eksperience shume te gjere ne fushen e punimeve te se njejtës natyre me objektit e prokuruar nga ana juaj , me aktivitet qe nga viti 2016.

Se treti, ne kemi ne stafin tone drejtues teknik te profesioneve te ndryshem si Kimist, Teknolog, Veteriner, Shofer, Shpmdares ushqimi dhe fumitor qe perbejne nje garanci te mjaftueshme per realizimin e objektit te prokurimit. Po ashtu do te angazhohen edhe specialiste te tjere nese eshte e nevojshme.

Se katerti, ne kemi mareveshje bashkepunimi me furnitor te ndryshem qe ne teresi prodhojne dhe tregtojne te gjithe artikujt e tenderit. Para dhenies se ofertes kemi marre oferta per te gjithe artikujt perberes te preventivit. Konkretisht nga subjekti “A-D-E-G” sh.p.k. me nipt K 86604010 G, subjekti “Ersen Muja” P.F. me nipt L96602005 L, subjekti “Andi Cocja” P.F, me nipt K 66702005 H. Po ashtu kemi edhe mallra gjendje ne magazine sipas fatures respektive te blerjes.

Nese do jemi fitues te kesaj procedure prokurimi, do zbatohen me perpikmeri te gjitha rregullat e sigurimit teknik te percaktuara ne Kodin e Punes, do te zbatohen edhe te gjitha detyrimet per kategorite e punetoreve.

Do bashkerendojme fuqine punetore te kualifikuar me realizimin ne cilesi shume te mire te shperndarjes se ushqimit ne vendet dhe oraret e percaktuara nga AK. Originaliteti i puneve tona vertetohet me ane te CV-se se shoqerise tone ne te cilen pasqyrohen objekte te realizuara sipas kerkesave te investitoreve pothuajse ne te gjitha vendet e Shqiperise, Shkoder, Tirane, Kukes, Rreshen, Lezhe, etj).

Gjithashtu, kemi automjete ne cilesi shume te mire, qe sherbejne per shperndarjen e artikujve dhe ruajtjen e tyre ne cilesi shume te mire.

Per pjesen me te madhe te artikujve perberes te preventivit kemi kontrata furnizimi me prodhuesit te cilat jane ngarkuar ne SPE.

Referuar statusit te subjektit dhe eksperiences se tij disavjecare kemi akses te plote per te marre ndihme shteterore, duke qene se jemi treguar shume korrekt me te gjitha institucionet e administrates shteterore. Po ashtu kemi edhe mundesi financimi nga bankat e niveleve te dyta.

Per sa i perket anes ekonomike bazuar sa me siper, ne momentin e pergatitjes se ofertes eshte menduar qe fitimi eventual nga ana jone te jete fare minimal dhe objekti te realizohet ne kohen dhe cilesine e duhur.

Bashkengjitur ofertat paraprake dhe faturat e blerjes.”. Përveç kësaj, ankimuesi në mbështetje të deklarimeve më sipër, ka paraqitur si dokument argumentues të ofertës së tij, disa oferta të marra nga furnizues të tjerë, për artikujt objekt-prokurimi, ku konstatohet se çmimi i secilit prej artikujve në këto oferta, është disa herë më i ulët se çmimi i ofertuar për to nga operatori ekonomik “Sead – SGS” SHPK, në ofertën e tij për procedurën objekt - shqyrtimi. Pra sa më sipër, operatori ekonomik “Sead SGS” SHPK argumenton ofertën e tij, se ka ofertuar me çmim disa herë më të lartë se ofertat e marra nga furnizues të ndryshëm për këto artikuj.

III.1.7. Gjykojmë, se operatori ekonomik “Sead – SGS” SHPK, në rastin konkret ka arritur nëpërmjet dokumentacionit provues sa më sipër, të argumentojë të gjitha elementet e ofertës së tij, përveç argumentimit në formën e një narrative, ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet favorizuese që disponon, të tilla si eksperiencia e gjatë në treg apo realizmi i një sërë kontratash me subjekte të ndryshme.

Në rastin konkret, gjykojmë, se nga ana e operatorit ekonomik “Sead – SGS” SHPK janë dorëzuar të gjitha dokumentat provuese mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike, mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe ose ndonjë kusht favorizues, origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi, duke argumentuar plotësisht, se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Argumentimi i dhënë nga ofertuesi, në rastin konkret krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “El – Gjo 2006” SHPK, nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “El – Gjo 2006” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-89259-11-30-2023, me objekt: “*Blerje artikuj te ndryshem ushqimor (shkolla Speciale 3 Dhjetori dhe Konvikti i shkolles Artistike)*”, me fond limit 2,436,275 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datë 11.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit të prokurimit publik.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “El – Gjo 2006” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri